



**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSIONI I RRUGES MANGANA”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45233120-6** Punime ndërtimi për rrugë

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës **136,666,667** (Njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë ) lekë **pa TVSH** , vënë në dispozicion nga **buxheti i Bashkisë Himarë**.

- **Viti 2025 41,666,667** (dyzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

- **Viti 2026 95,000,000** (nëntëdhjetë e pesë milionë ) lekë pa tvsh.

**Perilogaritja e fondit limit** dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlloragatur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

### 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022**, **2023**, dhe **2024** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së

*parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkua për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkua për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi

i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** dhe **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40 %** e vlerës së përllëgëruar të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;  
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor të delaruara në organet tatimore.*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- vi. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- NP.1 – Punime Germimi ne toke

**Klasifikimi C**

- **N.P. 4** - Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale **Klasifikimi C**
- **N.P. 5** Punime nëntokësore **Klasifikimi A**
- **NP-7** Punime ujesjellesa vepra kullimi e vaditje etj **Klasifikimi A**
- **N.P. 12** Punime të inxhinierisë mjedisore **Klasifikimi A**

▪ **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**

- **NS-6** Sinjalistika rrugore jondriçuese **Klasifikimi A**
- **NS-7** Barriera dhe mbrojtja rrugore **Klasifikimi A**
- **NS-18** Punime topogjeodezike – **Klasifikimi A**

*\* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

\* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licenca Profesionale.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuara	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në

			<b>kategorinë respektive</b>	<b>kategorinë përkatëse</b>
NP-1	Punime gjurmimi në tokë.	Punime gjurmimi dhe, Punime prishje, Punime gjurmimi shkëmbi i fortësive të ndryshme me ekskavator	C	51-100 milion
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Shtresa rrugore dhe punime të tipologjive të rrugeve dytësore dhe/ose linja të punimeve	C	51-100 milion
N.P. 5	Punime nëntokësore	Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.	A	0-21 milion
NP-7	Punime ujësjetuese vepra kullimi e vaditjeve	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.	A	0-21 milion
NP-12	Punime të inxhinierisë mjedisore	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.	A	0-21 milion
NS-6	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.	A	0-21 milion
NS-7	Barriera dhe mbrojtja rrugore	Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si guard rail, në jersey, zvogëluarit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.	A	0-21 milion

NS-18	Punime topogjeodezike	Punime topogjeodezike	A	0-21 milion
-------	-----------------------	-----------------------	---	-------------

### 2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** (*Sistem i Menaxhimit te Cilesise*)
- **ISO 14001:2015** (*Sistem i Menaxhimit Mjedisor*)
- **ISO 45001:2018 Ose ISO 45001:2023** (*Sistem i Menaxhimi i sigurise dhe Shendetit ne pune*)
- **ISO 39001-2012** (Per menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor)

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor,gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit



dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kyhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikat më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

- ISO 39001:2012 (Sistem i Menaxhimi i sigurisë së Trafikut Rrugor) Në vlerësimin e AK shihet e nevojshme pasja e certifikimit në lidhje me Sistem i Menaxhimi i sigurisë së Trafikut Rrugor duke pasur parasysh se ky objekt në pjesën më të madhe të gjatësisë së tij shtrihet përgjatë aksit Bypass të qytetit, duke konsideruar praninë e mjeteve të renda teknike të cilat do të hyjnë dhe dalin në kantier dhe objekt, AK kërkon standartine mbrojtjes së përdoruesve të rrugës gjatë punimeve në këto objekte.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **108 (njqind e tete) punonjës**, me koë të plotë pune, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Staf i menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi :** Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **108 (njqind e tete)** punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, me koë të plotë pune, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së

punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë,drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Përlllogaritja e numrit total të punonjësve është bërë në bazë të manualit teknik të punimeve.

### 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libeze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni 2 (dy) **Inxhinier Ndërtimi (me profil strukturist)**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeoteknik**
- Minimuni 1(një) **Inxhinier Mjedisi (me VNM)**
- Minimuni 1(një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/**
- Minimuni 1(një) **Inxhinier Mekanik**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi :**Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të

jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Kërkesa për 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatës lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Konkretisht:** Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislati i punimit e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

**Inxhinieri i Ndërtimit** (*me profil infrastrukturë transporti*) është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar

punimeve të parashikuara në preventiv, duke siguruar zbatimin e saktë të projektit dhe duke pasur parasysh Specifikimet Teknike dhe projektin e miratuar, inxhinieri me profil në infrastrukturë transporti lypet mjaft i nevojshëm në këtë projekt.

**Inxhinieri Gjeoteknik**, ben ndjekjen e zbatimit te punimeve duke pasur parasysh natyren e objektit, dhe vleresuar dhe kontrolluar standartet teknike gjate nderhyrjes. Gjithashtu duke pasur parasysh raportin gjeologjik tw paraqitur nga projektuesi, qwndrueshmwrinw e shtresave rrugore dhe afwrsinw me objektet private tw banimit, inxhinieri do tw bwjw tw mundur garantimin e cilwsisw sw punimeve.

**Inxhinier Topograf**, i cili do te beje piketimin e sakte te objektit dhe me pas vleresimin topografik te tij, duke pasur ne konsiderate vendndodhjen e veshtire te objektit.

**Inxhinier Hidroteknik**, i domosdoshëm për punimet dhe veprat e kullimit dhe ujërave të bardha. Do të garantojë zbatimin e projektit duke zbatuar në mënyrë rigoroze projektin dhe jetgjatësinë e investimit. Konkretisht kapitulli Nr 7 i preventivit si dhe analizat e bazuara në projekt

**Inxhinier Mjedisi**, I nevojshëm për zbatimin e projektit duke minimizuar efektin në mjedis gjatë zbatimit dhe më pas përdorimit të investimit. Në zbatim të raportit të ndikimit në mjedis, VNM-së, ky specialitet inxhinierik shihet i nevojshëm nga AK.

**Inxhinier Mekanik**, i nevojshem per zbatimin e punimeve te cilat kerkojne vleresimin mekanik te veprave te artit. Duke konsideruar se rruga eshte objekt i cili do te zgjerohet dhe trasheja nga fillimi, ky inxhinier do te vleresoje vepren ne teresi dhe qendrueshmerine e saj mekanike.

Nga shoqëria kërkohet dhe një azhornim i saktë i këtij investimi në përfundim.

**b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit te punimve, si më poshtë:**

- Teknik i Mesëm Ndërtimi - jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Hidroizolues -jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Elektracist - jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Hidraulik - jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Saldator - jo më pak se **1 (një)** punonjës
  
- Punëtorë të thjeshtë– jo më pak se **20 (njetete)** punonjës

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë ne listepagesat të shoqërisë minimalisht per periudhen 3 muajt e fundit.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e

kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka leshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me siper.

*Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.*

\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

*Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

### **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Teknik i mesem Ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit. i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve të analizave dhe preventivit.
- **Hidroizolues**, Punonjësi hidroizolues është përgjegjës për aplikimin e materialeve të hidroizolimit në ndërtesa, tarraca, themele, çati, bodrume apo sipërfaqe të tjera me qëllim parandalimin e depërtimit të ujit dhe lagështirës.
- **Elektricitist**, Punonjësi elektrikist është përgjegjës për instalimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve elektrike në përputhje me standardet teknike dhe rregulloret në fuqi. Ai/ajo siguron që të gjitha pajisjet dhe instalimet elektrike të funksionojnë në mënyrë të sigurt dhe efikase.
- **Hidraulik**, është përgjegjës për instalimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve hidraulike dhe sanitare, përfshirë tubacionet e ujit të ftohtë dhe të ngrohtë, sistemet e ngrohjes, kanalizimet dhe pajisjet e ndryshme sanitare në ndërtesa banimi, komerciale apo industriale.
- **Saldator**, I cili do të ketë funksionet si: Kryen punime saldimit sipas projekteve dhe standardeve teknike të caktuara. Përgatit dhe kontrollon materialet dhe mjetet para fillimit të procesit të saldimit. Lexon dhe interpreton skema teknike dhe vizatime për punët që duhet të kryhen. Siguron cilësinë e punës dhe përfundimin e saktë të saldimeve sipas specifikimeve.

Zbaton masat e sigurisë teknike gjatë gjithë procesit të punës. Mirëmban pajisjet e saldimit dhe kujdeset për mjetet e punës. Raporton çdo defekt teknik ose problem të identifikuar gjatë punës.

- **Punëtorë të thjeshtë, të cilët do të realizojnë të gjitha punët e pa specializuara në kantier, në përputhje me normat dhe standartet teknike**

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

- a) Operatori ekonomik duhet të disponoje 2 (dy) punojës i cili të jetë i pajisur me certifikatë “Koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "Për sigurinë në kantier", VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- a) Operatori ekonomik duhet të disponoje 1(nje) punojës i cili të jetë i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ligjit Nr. 152/2015 "Per shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojë në listëpagesat

e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, Ose te sigurohet ng opertori ekonomik nepermjet kontrakimit.

**Argumentimi:** Për të garantuar sigurinë maksimale të punonjësve dhe zbatimin e detyrimeve ligjore në kuadër të shëndetit dhe sigurisë në punë, operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën një (1) punonjës të kualifikuar dhe të pajisur me certifikatë si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.

Ky pozicion është thelbësor për arsyet e mëposhtme:

Përmbushja e kërkesave ligjore

Sipas ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe akteve nënligjore në fuqi, çdo subjekt duhet të marrë masa për të siguruar ndihmën e parë në rast emergjencash dhe aksidentesh në vendin e punës.

Reagim i menjëhershëm në situata emergjente

Në rast të një aksidenti në vendin e punës, prezenca e një eksperti të trajnuar garanton ndërhyrje të shpejtë dhe efektive, duke reduktuar rrezikun për pasoja më të rënda shëndetësore apo dëme të tjera.

Parandalimi dhe menaxhimi i situatave kritike

Një profesionist i certifikuar është në gjendje të organizojë planin e reagimit emergjent, të trajtojë punonjësit e tjerë mbi masat bazë të sigurisë dhe të jetë përgjegjës për pajisjet e ndihmës së parë dhe protokollet e evakuimit në rast rreziku.

Rritja e nivelit të përgjithshëm të sigurisë në vendin e punës

Prania e një eksperti për ndihmën e parë nxit ndërgjegjësimin dhe respektimin e standardeve të sigurisë, si dhe kontribuon në një kulturë pune të shëndetshme dhe të përgjegjshme.

Vlerë e shtuar për projektin apo kontratën

Pjesëmarrja e një punonjësi të specializuar në fushën e emergjencave rrit nivelin profesional të operatorit ekonomik dhe garanton autoriteteve kontraktuese se janë marrë masat e duhura për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të të gjithë punonjësve të përfshirë.

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. OE ofertues referuar

Ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 “Per sigurinë dhe shendetin në punë”, VKM Nr. 108 datë 09/02/2011 “Për aftësin që duhet të plotësojnë punëmarrësit personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar, duhet të ketë të paktën një mjek .

d) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
  - CV përkatëse
  - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
  - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

**Argumentimi :**Kërkesat e mësipërme janë vendosur vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure



lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- Manovrate/Eskavatoriste – jo më pak se **4 (kater)** punonjës
- Manovrate/Buldozerist - jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Automakinist – jo më pak se **4 (kater)** punonjës
- Shofer – jo më pak se **3 (tre)** punonjës

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet te perkoje me kerkesat e profilit te deklaruar per cdo punojes.
- Të figurojnë në listëpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë te rregjistruar sipas legjislacionit ne fuqi.
- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punojesit eskavatoriste, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, daten e kontrates se punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist / buldozeristet , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon te drejten e verifikimit te deklarimeve per punojesit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do te jete kusht per skualifikimin e ofertes.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferët janë të nevojshëm për shkak të makinerive të ndryshme që do të kryejnë punime germimi, ngjeshje materiali etj.

### 2.3.7 (Makineri, Pajisje)

**Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

<b>Nr</b>	<b>Lloji i Makinerive</b>	<b>Statusi</b>	<b>Sasia</b>
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
3	Kamioncine	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Fadrome me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Greider	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Asfaltoshtuese	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Eskavatore me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Cekic pneumatik	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Rrul gome-hekur kapaciteti mbi 20 t	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Rrul vibrues deri 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Rrul hekur-hekur	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Makineri vijezi	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Makineri për vendosje guardreila	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Pompe thithese uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Kompresor ajri	në pronësi ose me qira	Copë 4
22	Vinç	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Fabrikë Betoni (e paisur me leje mjedisore kodë III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
24	Fabrikë asfaltbetoni (e paisur me leje mjedisore kodë III.1.B )	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
25	Nyje Inerte (e paisur me leje mjedisore kodë III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
26	Helikopter betoni	në pronësi ose me qira	Cope 1
27	Bob cat	në pronësi ose me qira	Cope 1

28	Mini ekskavator	në pronësi ose me qira	Cope 1
29	Aparat topogjeodezik	në pronësi ose me qira	Cope 1
30	Total Station	në pronësi ose me qira	Cope 1
31	Dumper 35 t	në pronësi ose me qira	Cope 1

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo më pak se 108 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme – jo më pak se 8 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 45 copë

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- **Për paisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- **Për paisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të

*provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

**Shënim:** Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

- Dumper 35 ton referuar analizave 3.124/1a, 3.124/2a, 3.47/1b
- Kamionçine e nevojshme për transporte të ndryshme jashtë kantierit

- Autopompe betoni, e nevojshme per betonime te strukturave tw armuara sipas manualit Nr 3.240, 3.205, 3.247
- Autobetoniere,e nevojshme per betonime te strukturave tw armuara sipas manualit Nr 3.240, 3.205, 3.247
- GPS Geost, e nevojshme per matjet dhe planvendosjen e sakte te objektit
- Ekskavator me zinxhire, referuar kapitullit 5, punime germimi
- Fadrome me goma, e nevojshme per pune dhe sistemime ne hapësira te ngushta
- Grejder, i nevojshem per perhapjen e njetratjeshem te shtresave pergjate gjithë segmentit
- Asfaltshtruese, per shtrimin e asfaltit dhe binderit
- Rrul me dhembe min 15 ton, i nevojshem per ngjeshjen e shtresave ne kombinim me grejderin dhe mjete te tjera teknologjike
- Rrul ngjeshës min 20 ton,i nevojshem per ngjeshjen e shtresave ne kombinim me grejderin dhe mjete te tjera teknologjike,

2.3.13 Operatori ekonomik duhet te kete kontratë me një laborator të akredituar ku të jetë përcaktuar objekti i kontratës/procedurës, për kryerjen e testeve gjatë fazës së zbatimit si dhe përfundimit të objektit. Laboratori duhet të jetë i akredituar për testet e poshtë shënuar, të certifikuar në përputhje me S SH ISO/ICE 17025:2017

**Argumentimi** Ne baze te nenit 77 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe piken 8, te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", me ane te ketij kriteri AK gjykon se disponimi ne pronesi apo me qera i ketyre fabrikave eshte nje dokument i rendesishem, pasi pervec se tregon origjinen e mallrave qe kerkohen ne procedure, garanton se ofertuesi eshte i garantuar per ofrirmin tek Autoriteti Kontraktor te ketyre mallrave qe do te perdoren ne punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilesore te mallrave objekt prokurimi te cilat kerkohen qe te jene prodhuar ne perputhje me standardet dhe cilesite e kerkuara ne DST. Ky kriter eshte ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejte me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise se OE per permbushjen me sukses te kontrates pasi sasia e produkteve qe do te perdoren eshte e konsiderueshme.

2.3.14 Operatori ekonomik per materialet elektrike referuar zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike duhet te paraqese:

1. Autorizim te prodhuesit/ve/distributor/ve per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. (Ne rastet kur autorizimi eshte ne gjuhe te huaj duhet te behet perkthimi ne gjuhen shqipe dhe noterizimi i tij.)

Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata e angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit . (të përkthyer në shqip dhe te noterizuara).

2. Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit/ve per listen e mesiperme, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen ne gjuhen shqipe ose angleze.

3. Shoqëria prodhuese duhet të ketë certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalent, ISO 14001:2015 ose ekuivalent (ku të çilesohet në fushën e aktivitetit prodhimi i tubave) , dhe certifikatat e konformitetit për to.

- ***Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë e katalogut të prodhuesit dhe të japë mundësinë Autoritetit Kontraktor të gjurmojë on-line këta kataloge/fragmente katalogesh.***

**Argumentimi:** Për të garantuar cilësinë, origjinën, përputhshmërinë me specifikimet teknike si dhe gjurmueshmërinë e produkteve që do të përdoren në realizimin e kontratës, Operatorët Ekonomikë duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme, të cilat janë të domosdoshme për të siguruar standarde të larta teknike dhe profesionale:

#### 1. Autorizim i Prodhuesit/Distributorit

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi apo distributori zyrtar për mallrat e listuara në preventiv ka për qëllim të:

Sigurojë origjinën e ligjshme dhe të dokumentuar të materialeve që do të furnizohen.

Mundësojë verifikimin nga ana e Autoritetit Kontraktor të të dhënave të prodhuesit apo distributorit, nëpërmjet kontakteve zyrtare (telefon, fax, e-mail, website).

Shmangë ndërmjetësit joformalë dhe garantojë që operatori ekonomik ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë ose të autorizuar me burimin zyrtar të furnizimit.

Në rastet kur paraqitet autorizim nga një distributor, kërkohet kontrata e angazhimit ndërmjet prodhuesit dhe distributorit, për të siguruar që distributori është i autorizuar zyrtarisht për tregtimin e produkteve përkatëse.

Ky dokumentacion është i rëndësishëm për të garantuar transparencën dhe besueshmërinë në procesin e furnizimit.

#### 2. Katalogë ose Fragmente Katalogësh të Prodhuesit

Kërkesa për katalogë teknikë në gjuhën shqipe ose angleze për produktet që do të ofrohen ka për qëllim të:

Verifikojë përputhshmërinë teknike të materialeve të ofruara me specifikimet teknike të kontratës.

Sigurojë që produktet janë të standardeve të certifikuara, të pranuar ndërkombëtarisht.

Jep mundësi Autoritetit Kontraktor të krahasojë karakteristikat teknike me dokumentacionin e tenderit në mënyrë të qartë dhe transparente.

Katalogët janë dëshmi zyrtare nga prodhuesi për cilësitë dhe karakteristikat teknike të çdo materiali, dhe janë instrument kyç për vlerësimin teknik të ofertave.

#### 3. Certifikatat ISO dhe Certifikatat e Konformitetit

Kërkesa që shoqëria prodhuese të ketë:

Certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalent – për sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Certifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalent – për menaxhimin e mjedisit, ku të specifikohet që ka të bëjë me prodhimin e tubave.

Certifikatat e konformitetit për produktet – që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet përkatëse evropiane ose ndërkombëtare.

Këto certifikata janë të domosdoshme për të:

Garantuar që produktet janë të cilësisë së qëndrueshme dhe të kontrolluar.

Sigurojë që prodhuesi respekton praktikën e mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë në prodhim.

Mbrojtur interesin publik dhe investimin e Autoritetit Kontraktor duke përdorur materiale që plotësojnë të gjitha standardet ligjore dhe teknike.

### 2.3.15 Operatori ekonomik për Puseta Polipropileni duhet të paraqesë:

1. Autorizim të prodhuesit/ve/distributor/ve për listën e mesiperme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. (Në rastet kur autorizimi është në gjuhë të huaj duhet të bëhet përkthimi në gjuhën shqipe dhe noterizimi i tij.)

*Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata e angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit . (të përkthyer në shqip dhe të noterizuara).*

2. Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mesiperme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen në gjuhën shqipe ose angleze.
3. Shoqëria prodhuese duhet të ketë certifikatë ISO 9001:2015 *ose ekuivalent* , ISO 14001:2015 *ose ekuivalent* (ku të çilesohet në fushën e aktivitetit prodhim i tubave) , dhe certifikatat e konformitetit për to.

***Shënim:*** *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogut të prodhuesit dhe të japë mundësinë Autoritetit kontraktor të gjurmëve on-line këta kataloge/fragmente katalogesh*

#### **Argumentimi:**

Në funksion të garantimit të cilësisë së lartë të materialeve që do të përdoren në kuadër të realizimit të kontratës, si dhe për të siguruar përputhshmërinë e tyre me standardet teknike të kërkuara, është e domosdoshme që Operatorët Ekonomikë të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm justifikues dhe vërtetues:

#### 1. Autorizim nga Prodhuesi/Distributori

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit zyrtar për pusetat prej polipropileni synon të:

Garantojë origjinën zyrtare dhe legjitimitetin e produkteve të ofruara, duke shmangur furnizimet nga burime të paautorizuara ose jo të gjurmueshme.

Sigurojë që operatori ekonomik ka një lidhje të drejtpërdrejtë me prodhuesin ose distributorin zyrtar, çka ndihmon në respektimin e kushteve teknike dhe afateve të furnizimit.

Mundësojë verifikimin e të dhënave të subjekteve përkatëse nga Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet të dhënave të kontaktit (telefon, email, fax, website).

Në rastin e autorizimit nga një distributor, kontrata e angazhimit ndërmjet prodhuesit dhe distributorit duhet të dorëzohet për të konfirmuar marrëdhënien zyrtare të përfaqësimit dhe autorizimit të furnizimit.

Ky dokumentacion është jetik për të siguruar transparencë, përgjegjësi dhe kontroll të burimit të materialeve që do të përdoren në zbatim të kontratës.

## 2. Katalogë ose Fragmente Katalogësh të Prodhuesit

Paraqitja e katalogëve zyrtarë ose fragmenteve të tyre (në gjuhën shqipe ose angleze), të cilët specifikojnë karakteristikat teknike të pusetave prej polipropileni, është e rëndësishme për:

Verifikimin e përputhshmërisë teknike të produkteve me specifikimet e preventivit dhe dokumentacionit teknik të tenderit.

Sigurimin që produktet e ofruara janë produkte të standardizuara dhe të dokumentuara nga prodhuesi, jo modele të panjohura ose të paqarta.

Lehtësimin e procesit të vlerësimit teknik dhe krahasimit të ofertave nga autoriteti kontraktor, mbi baza objektive dhe të dokumentuara.

Ky dokumentacion eliminon çdo pasiguri mbi cilësinë, llojin dhe karakteristikat e produkteve të ofruara.

## 3. Certifikatat ISO dhe Certifikatat e Konformitetit

Kërkesa që prodhuesi të zotërojë certifikata ndërkombëtare është vendosur për të siguruar që materialet të jenë të prodhuara në përputhje me standardet më të larta të industrisë:

ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) – garanton që kompania ka implementuar një sistem efektiv të menaxhimit të cilësisë, duke kontrolluar çdo hallkë të procesit të prodhimit.

ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) – tregon angazhimin për menaxhimin mjedisor dhe përputhshmërinë me kërkesat për mbrojtjen e ambientit gjatë procesit të prodhimit.

Certifikatat e konformitetit – janë prova që produktet përmbushin standardet e aplikueshme teknike dhe ligjore, si për qëndrueshmërinë fizike të materialit, rezistencën ndaj kimikateve, ujërave, etj.

Përfshirja e këtyre certifikatave është garanci për Autoritetin Kontraktor që materialet janë të sigurta, të qëndrueshme, dhe të certifikuara për përdorim në infrastrukturë publike.

### 2.3.16 Operatori ekonomik për referuar zerave të preventivit që lidhen me Sinjalistikën rrugore dhe specifikimeve teknike duhet të paraqesë

1. Autorizim të prodhuesit/ve/distributor/ve për listën e mesipërme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. (Në rastet kur autorizimi është në gjuhë të huaj duhet të bëhet përkthimi në gjuhën shqipe dhe noterizimi i tij.)

*Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata e angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit . (të përkthyer në shqip dhe të noterizuara).*

2. Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mesipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen në gjuhën shqipe ose angleze.
3. Shoqëria prodhuese duhet të ketë certifikate ISO 9001:2015 **ose ekuivalent**, ISO 14001:2015 **ose ekuivalent** (ku të çilesohet në fushën e aktivitetit prodhimi i materialeve të sinjalistikës rrugore ), dhe certifikatat e konformitetit për to.



**Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogut te prodhuesit dhe ti jape mundesine Autoriteti kontraktor te gjurmoje on-line keta**

**Argumentimi:**

Në funksion të garantimit të cilësisë së lartë të materialeve që do të përdoren në kuadër të realizimit të kontratës, si dhe për të siguruar përputhshmërinë e tyre me standardet teknike të kërkuara, është e domosdoshme që Operatorët Ekonomikë të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm justifikues dhe vërtetues:

**1. Autorizim nga Prodhuesi/Distributori**

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit zyrtar për pusetat prej polipropileni synon të:

Garantojë origjinën zyrtare dhe legjitimitetin e produkteve të ofruara, duke shmangur furnizimet nga burime të paautorizuara ose jo të gjurmueshme.

Sigurojë që operatori ekonomik ka një lidhje të drejtpërdrejtë me prodhuesin ose distributorin zyrtar, çka ndihmon në respektimin e kushteve teknike dhe afateve të furnizimit.

Mundësojë verifikimin e të dhënave të subjekteve përkatëse nga Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet të dhënave të kontaktit (telefon, email, fax, website).

Në rastin e autorizimit nga një distributor, kontrata e angazhimit ndërmjet prodhuesit dhe distributorit duhet të dorëzohet për të konfirmuar marrëdhënien zyrtare të përfaqësimit dhe autorizimit të furnizimit.

Ky dokumentacion është jetik për të siguruar transparencë, përgjegjësi dhe kontroll të burimit të materialeve që do të përdoren në zbatim të kontratës.

**2. Katalogë ose Fragmente Katalogësh të Prodhuesit**

Paraqitja e katalogëve zyrtarë ose fragmenteve të tyre (në gjuhën shqipe ose angleze), të cilët specifikojnë karakteristikat teknike të pusetave prej polipropileni, është e rëndësishme për:

Verifikimin e përputhshmërisë teknike të produkteve me specifikimet e preventivit dhe dokumentacionit teknik të tenderit.

Sigurimin që produktet e ofruara janë produkte të standardizuara dhe të dokumentuara nga prodhuesi, jo modele të panjohura ose të paqarta.

Lehtësimin e procesit të vlerësimit teknik dhe krahasimit të ofertave nga autoriteti kontraktor, mbi baza objektive dhe të dokumentuara.

Ky dokumentacion eliminon çdo pasiguri mbi cilësinë, llojin dhe karakteristikat e produkteve të ofruara.

**3. Certifikatat ISO dhe Certifikatat e Konformitetit**

Kërkesa që prodhuesi të zotërojë certifikata ndërkombëtare është vendosur për të siguruar që materialet të jenë të prodhuara në përputhje me standardet më të larta të industrisë:

ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) – garanton që kompania ka implementuar një sistem efektiv të menaxhimit të cilësisë, duke kontrolluar çdo hallkë të procesit të prodhimit.

ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) – tregon angazhimin për menaxhimin mjedisor dhe përputhshmërinë me kërkesat për mbrojtjen e ambientit gjatë procesit të prodhimit.

Certifikatat e konformitetit – janë prova që produktet përmbushin standardet e aplikueshme teknike dhe ligjore, si për qëndrueshmërinë fizike të materialit, rezistencën ndaj kimikateve, ujërave, etj.

Përfshirja e këtyre certifikatave është garanci për Autoritetin Kontraktor që materialet janë të sigurta, të qëndrueshme, dhe të certifikuara për përdorim në infrastrukturë publike.

Leje mjedisore e keshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për ”Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve” më Kod III.2.B

**Argumentimi:** Të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në grumbullim dhe transportim mbetjesh, duke përfshirë por jo përjashtuar mbetjet e ngurta inerte, duhen të pajisen me lejen e posaçme me kod III.2.B, e cila siguron përputhshmërinë me anën ligjore dhe teknike të legjislacionit, duke siguruar mbledhjen, grumbullimi, transportin dhe depozitimin e mbetjeve sipas standardeve të kërkuara dhe në mbrojtje të mjedisit.

2.3.17 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar, i Preventivin si dhe analizen e cmimeve për zerrat e preventivit, (Bashkëlidhur DST) në dokumentat e tenderit. Në rast BOE grafikun e punimeve duhet të jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

*Specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.162/2020 “ Per prokurimin Publik” dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinier i licensuar dhe do të bashkengjiten dokumentave të tenderit në SPE.

## NJESIA E PROKURIMIT

**Orest Vela**

**Uran Dulaj**

**Aristidh Goro**